

## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 27.07.2023

Kryesuesi i mbledhjes është Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 10:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 27

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh: 27

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: 1

Të pranishëm në mbledhje qytetarë:

### **Pika 1 e rendit të ditës.**

#### **PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Janë 3 materiale shitesë që do ti shtohen rendit të ditës, pas pikës 10, pra 11 ,12, 13 dhe renditja do të spostohet. Kush është dakord?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 2 e rendit të ditës.**

#### **PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 23- QERSHOR 2023 DHE 29-QERSHOR 2023 .**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju është dërguar me email, besoj secili nga këshilltarët e ka lexuar. Ka ndonjë mendim apo kundërshtim?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 3 e rendit të ditës**

#### **PËR DISA NDRYSHIME NË V.K.B-në NR.91 DATË 29.06.2023 " PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË**

Kryetari i Këshillit A.Verushi : Kush është dakord edhe me këtë?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 4 e rendit të ditës.**

**MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUdhËN 1 – 30 QERSHOR 2023.**

Këshilltare A.Taho: Komisioni është mbledhur ditën e hënë, kemi dëgjuar dhe jemi sqaruar për të gjitha pikat e trajtuara në këtë çështje. Komisioni ka vendosur që kjo pikë ti kalojë këshillit për tu miratuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nga anëtarët e tjerë të komisionit ka ndonjë vendim?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 5 e rendit të ditës.**

**MBI SISTEMIN E PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHEN E PËRFITUESËVE TË PROGRAMIT "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË".**

Këshilltare A.Taho: Edhe në këtë pikë komisioni ka diskutuar me Mirelën për të gjitha paqartësitë që ka patur ka marrë sqarimin e duhur dhe kemi vendosur që ti kalojë këshillit për miratim edhe kjo pikë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nga këshilltarët e tjerë ka ndonjë pyetje?

Këshilltare I.Seidolli: Unë në fakt kam një propozim që vlen për të treja çështjet sociale, secila kategori duhet të ketë patjetër 25 pikë, por unë në këndvështrimin tim mendoj se individët me statusin e jetimit janë vlerësuar me 2 pikë dhe anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian janë vlerësuar me 4 pikë dhe janë On top në këtë kategori. Mendoj që në këndvështrimin tim të bëhet një dhurim pikësh për shkak se anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptianë vlerësohen si njërëz me të drejta të barabartë dhe për aq kohë sa janë të aftë për të zhvilluar veprimtari ekonomike apo sociale ndryshe nga individët me statusin e jetimit të cilët përballimin e jetesës do ta kenë shumë herë më të vështirë sepse janë vetëm. Unë propozoj që pikëzimin e antëarëve të komunitetit rom

dhe egjiptian nga 4 të ulet dhe të bëhet 3 dhe 1 pikë ti dhurohet individëve me statusin e jetimit kështu që të dyja kategoritë do të ishin me 3 pikë dhe përsëri nuk do të bënte një ndryshim shumë të madh për shkak se ata prevalojnë në rëndësinë e tyre.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjalën e ka ekzekutivi për të bërë një sqarim dhe nëse është i mundur ky propozim që sapo u citua.

Ekzekutivi M.Balli: Në shpërndarjen dhe në formimin e pikëzimit ne gjithmonë kemi pasur parasysh statistikat e aplikantëve që kemi trashëguar gjatë viteve dhe atyre që kemi aktualisht dhe nuk na rezulton që të kemi aplikantë të kësaj kategorie, kemi më shumë të kategorisë rome dhe egjiptiane, prandaj është bërë kjo shpërndarje. Patjetër nëse do të ketë ky është një nga kushtet, ky është kushti social dhe të gjitha shikohen në kompleks, shikohet kushti i strehimit, kushti familjar, ekonomik dhe diferenca prej dy pikësh që diskutohet nga ju në lidhje me komunitetin rom nuk përbën diferencë, nëse do ta kemi një rast si ky .

Këshilltari I.Seidolli: Po e kuptoj.

Ekzekutivi M.Balli: Prandaj mendoj që sistemi i pikëzimit që ju është paraqitur është gjithëpërfshirës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje?

Këshilltari E.Bregu : Në lidhje me sistemin e pikëzimit shikoj ata që kanë statusin e të përndjekurit politikë prej 32 vjetësh është bërë pothuajse asgjë në lidhje me çështjen e rehabilitimit të kësaj shtrese, ndërkohë që tani e shikoj që kjo shtresë nuk ka asnjë pikë në sistem. Për këtë desha të bëj diskutim dhe të shikohet mundësia që të trajtohet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse ishit të vëmendshëm dhe e dëgjuat përgjigjen e ekzekutivit kjo ka të bëjë jo me përkujdesin që nuk është treguar ndaj kësaj shtrese por sipas kërkesave që vijnë kjo shtresë në mënyrë që të futen në sistemin e pikëzimit. Megjithatë ekzekutivi mund ta sqarojë.

Ekzekutivi M.Balli: Në lidhje me pyetjen tuaj, në sistemin e pikëzimit kriteret dhe kategoritë janë të përcaktuara me ligj, ne nuk kemi të drejtë as të shtojmë as të pakësojmë . I referohemi nenit 16 të ligjit Për Strehimin Social, është i vitit 2018 dhe ndryshimit të ligjit që sapo është bërë në datën 10 korrik është në mënyrë taksative e përcaktuar kategoritë do ti referohen ligjit.

Këshilltari E.Bregu : Çfarë mund të bëhet për këtë?

Ekzekutivi M.Balli: Ne kemi për detyrë të zbatojmë ligjin.

Këshilltari E.Bregu : Po ne si këshill supozojmë që nuk jemi dakord çfarë ndodh?

Këshilltari P.Tollkuçi: Sigurisht që ne të gjithë vijmë këtu për të diskutuar për më të mirën e komunitetit që ne përfaqësojmë por padiskutim ne kemi marrë një vendimarrje që të gjithë ne këshilltarët sipas grupeve që ne i përkasim apo komisioneve më sakt brenda këtij këshilli. Ne kemi diskutuar në atë ditë që kemi përcaktuar dhe jemi të sqaruar sipas problematikave apo temave sipas rendit të ditës nga ana e ekzekutivit. Unë mendoj që kushdo këshilltar sigurisht që ka të drejtën e tij për të folur dhe për të diskutuar më të mirën e këtij komunitetit, por pjesa e diskutimit me ekzekutivin është e domosdoshme për të qënë të saktë. Sigurisht që çdo material që përgatit ekzekutivi është i bazuar në ligj. Unë mendoj që pjesa tjetër e diskutimit jashtë kornizave ligjore nuk mund të bëhet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do të sugjeroja dhe diçka tjetër, nëse keni diçka se kjo është për të zgjatur kohën, nëse do të kishit diçka në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës apo dhe me çdo pikë tjetër në të cilat ju nuk keni informacion, nuk ju pengon askush që të kërkonit shpjegime nga ekzekutivi më përpara sesa të vini në mbledhjen e këshillit ose mund të merrni pjesë në mbledhjet e komisioneve edhe pse nuk mund të jeni të përfshirë. Ne këtu jemi për të zbatuar ligjin dhe rregulloren.

Këshilltar E.Bregu : Në përgjigje të kësaj që the po të them që ne kemi qënë të informuar kemi patur dhe këshilltar në komision dhe përgjigjia ka qënë e tillë që kështu është ligji.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

Këshilltar E.Bregu : Materiali për ditën e sotme është shumë voluminoz dhe besoj që kërkon një kohë shumë të gjatë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Tani të lutem kur ne diskutuam për rendin e ditës kishe të drejtë të flisje që në fillim për mënyrën dhe pikat e rendit të ditës.

Këshilltar E.Bregu : Duke qënë që material është shumë voluminoz kam përshtypjen që anëtarët e këshillit bashkiak duhet të rrinë shumë orë që ta kalojmë të gjithë materialin ose të bëhet procedurë e përshpejtuar. Marr shkak dhe nga diskutimi i bërë gjatë muajit të kaluar në ëap në lidhje me mbledhjen që lihen javën e fundit të muajit mos ndoshta është më e përshtatshme që të lihen javën e 3 të muajit me qëllim që në rast se kemi volume më të mëdha pune të kemi mundësi të bëjmë dhe një mbledhje tjetër javën e 4.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E diskutojmë më vonë këtë propozimin tuaj.

### **Pika 6 e rendit të ditës.**

**MBI SISTEMIN E PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHEN E PËRFITUESËVE TË PROGRAMIT "SUBVENCIONIMI I QIRASË".**

Këshilltare A.Taho: Edhe për këtë pikë komisioni ka vendosur, pasi ka marrë sqarimet e duhura që ti kalojë këshillit për miratim . Duke qënë se Mirela na ka sqaruar çdo çështje të pikëzimit për të gjitha kategoritë në nevojë, nuk ka pasur paqartësi. I japim këshillit të drejtën për ta miratuar edhe këtë pikë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi : Nga këshilltarët ka ndonjë mendim tjetër?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 7 e rendit të ditës.**

**MBI SISTEMIN E PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHEN E PËRFITUESËVE TË PROGRAMIT " BANESAVE SOCIALE ME QIRA "**

Këshilltare A.Taho: Edhe për këtë pikë komisioni ka vendosur që t'ja kalojë këshillit për miratim pasi gjithcka është e qartë për komisionin. Pyetjet janë sqaruar, nuk e di për këshilltarët e tjerë nëse ka paqartësi apo jo.

Kryetari i Këshillit A.Verushi : Nëse nga këshilltarët nuk ka gjë tjetër e hedhim në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 8 e rendit të ditës.**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.181 DATË 28.12.2022 " PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2023".**

Këshilltar K.Kocibelli: Ditën e hënë komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative të Pasurive të Bashkisë pasi plotësoi korumin prej 3 anëtarëve të këshillit të bashkisë vendosi që ti kalojë këshillit për miratim duke patur parasysh që këshilli e ka marrë këtë VKM për të gjitha pagat e punonjësve. Në këto kushte edhe administrata e bashkisë së Korçës do të përfitojë nga kjo rritje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nga Komisioni i Ekonomisë.

Këshilltare A.Përmeti: Këto pika u diskutuan në komision, nga ana e ekzekutivit u dha shpjegim ku ishin të 3 anëtarët prezent. Normalisht ky është një vendim i cili i takon këshillit ku me kërkesë të bashkisë kërkohet të miratohet niveli i pagave për disa pozicione pune siç janë zjarrfiksit apo edukatorët. Ne ramë dakord si komision që të kalojë për miratim sepse ka të bëjë me fondin e rritjes së pagave të këtyre kategorive.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë propozim tjetër?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 9 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E RITJES SË PLANIT TË BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PËRDORIMIN E TRANSFERTAVE TË PAKUSHTËZUARA SEKTORIALE PËR RITJEN E PAGAVE DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETSORE.

Këshilltar P.Tollkuçi: Ne si komision të përbërë nga 3 veta nga unë Ada dhe Alketa, sigurisht që diskutuam me ekzekutivin në lidhje me këtë material dhe ramë dakord në parim dhe ftojmë këshillin për ta votuar këtë material.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 10 e rendit të ditës.**

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.181 DATË 28.12.2022 " PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2023"

Këshilltar P.Tollkuçi: Është rrjedhojë e pikës së mëparshme që diskutuam. Kemi folur me ekzekutivin me pjesën e financës së bashkisë jemi dakord për kalimin e këtij materiali në këshill.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët e tjerë?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 11 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E RITJES SË PLANIT TË BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PËRDORIMIN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR PËR RITJEN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PAS ZBATIMIT TË VKM NR. 326 DHE 328 DATË 31.5.2023.

Këshilltar P.Tollkuçi: Për të gjitha këto pika ne jemi të sqaruar dhe jemi dakord për kalimin e tyre dhe miratimin e tyre në këshill.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët e tjerë?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 12 e rendit të ditës.**

PËR NJË NDRYSHIM TË VKB NR. 183 DATË 28.12.2022 “MBI MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR TË VITIT 2023 DHE PBA 2023-2025 TË BASHKISË KORÇË, I NDRYSHUAR

Këshilltar P.Tollkuçi: Është pikë e fundit shtesë që ne diskutuam në komision dhe që materiali është paraqitur pranë këshilltarëve. Ta kalojmë në votim për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët e tjerë?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 13 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 NË NIVEL PROGRAMI .

Këshilltar P.Tollkuçi: Në lidhje me këtë pikë kemi diskutuar me ekzekutivin , jemi sqaruar. Kjo është një procedurë rutinë dhe që është detyrim i ekzekutivit për ta paraqitur pranë këshillit bashkiak, jemi sqaruar, kemi parë pasqyrat përkatëse dhe kemi rënë dakord për kalimin dhe miratimin e kësaj pike.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët e tjerë?

Këshilltare I.Seidolli: Kam dy pyetje në lidhje me këtë. Për projekt-buxhetin e vitit 2024 në çfarë raporti qëndron puna e gjatë pra paga+sigurime në raport me shpenzimet. Pyetja e dytë si është planifikuar rritja e të ardhurave, për cilat zëra përkatësisht dhe pyetja e 3 sa e mbulojnë koston e shpenzimit të ardhurat që parashikohen të shpenzohen për këtë vit 2023 nëpërmjet tarifave.

Ekzekutivi V.Ziko: Përqindja e raportit të pagave ndaj totalit të buxhetit është 40%, pagat dhe sigurimet shoqërore. Ndërsa në lidhje me shërbime p.sh shërbimi i pastrimit dhe ndriçimit pothuajse e mbulojmë 100% mbledhja e tarifave ndaj totalit të shpenzimeve. Për pyetjen e tretë në materialin e paraqitur është shkruar që për parashikimin e të ardhurave e cila është miratuar që në janar të vitit 2023 nga viti 2023 është llogaritur me 1%, dhe vetëm 1% 2024 në krahasim me 2023 , 2025 në krahasim me vitin 2024 1% dhe vitin 2026 1%. Ndërsa në zëra të detajuara nuk mund të ta them pasi këto janë pasqyra financiare të cilat janë një parashikim ndërsa detajimi se sa % do të rritet secila e ardhur këtë informacion do ta merrni kur të bëhet buxheti i 2024.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj u sqaruar këshilltare.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 14 e rendit të ditës.**

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR PRIVATIZIMIN E OBJEKTIT ME SIPËRFAQE 89.4 M2, NDËRTESEË E NDODHUR MBI PASURINË 1/930 ZK 8561, NË ISH PARKU AUTOMOBILSTIK KORÇË.**

Këshilltar I.Bode: Si fillim komisioni vendosi që ti kalojë këshillit për miratim, por gjithësesi unë do i kërkoja ekzekutivit që në mbledhjet e tjera të ishin më të plotë me dokumentacionin, për shkak se në këtë pikë thuhet që për fillimin e procedurave të privatizimit është bazuar në një kërkesë e cila është trashëgimtare e të ndjerit Sali Ismail. Pra do ishte më e saktë që të kishim dhe këtë certifikatën e trungut që e vërteton që realisht kjo zonja është trashëgimtare apo jo.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Nga ana e juridiksionit ta sqarojë Anxhela, po nuk është se është përgjegjësia jonë të meremi me këtë pjesë. Ne na ka ardhur si kërkesë, vjen dhe herë të tjera , na vijnë nga drejtoria e privatizimit tek Ministria e Financave dhe ne japim vetëm pëlqimin për të vazhduar procedurat e privatizimit, kurse procedurën për këto detajet ligjore teknike e ndjek kjo drejtoria e privatizimit. Nuk është çështje e bashkisë. Ne japim pëlqimin në parim.

Ekzekutivi A.Dishnica: Ne japim pëlqimin vetëm për pronën, nuk hyjmë fare në faktin që atje ka pronar apo nuk ka pronarë , apo në emër të kujt do të bëhet privatizimi.

Këshilltar I.Bode : Pra me pak fjalë në parim ne jemi dakord me atë që kërkohet.

Këshilltar E.Bregu: Kam një pyetje dhe diçka për procedurë, kjo pronë nuk është në funksion të bashkisë, bashkia nuk po e përdor si pronë?

Ekzekutivi A.Dishnica: Jo nuk po e përdor si pronë.

Këshilltar L.Petri: Sepse pastaj për çdo pronë që bashkia nuk përdor i bie të privatizohet.

Ekzekutivi A.Dishnica: Është VKM nr 926 i vitit 2014 i cili parashikon që nëse ministria vendoset në lëvizje nga një kërkesë të një qytetari për të bërë privatizimin të një objekti që mund të jetë në pronësi të institucioneve shtetërore apo pronësi të shoqërive tregëtare me kapital tërësisht shtetëror për këto i kërkohet pëlqimi institucionit përkatës, por edhe në rast se institucioni përkatës nuk e jep pëlqimin brenda një periudhe 30 ditore, Ministria mund ta vazhdojë këtë procedurë edhe pa këtë pëlqim, duke ndjekur ato hapat që i lejon KM. Kjo është thjesht një procedurë formale.

Këshilltar E.Bregu: Besoj se dhe për këtë pikë dhe për pikën në vijim mqs ne po flasim për pronë të bashkisë që po tjetërsohen apo po jepen për përdorim bazuar në ligjin Për Vetë qeverisjen vendore neni 55 këto përcaktohen që votohen nga 3/5 e të gjithë këshilltarëve , neni 55 pika 4 vendimet merren me jo më pak se 3/5 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit , në rast se



parashikohen në pikë e) dhe pika e) miraton tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronave të treta. Besoj se jemi në kuadër apo jo.

Ekzekutivi A.Dishnica: Përveç e) është shtuar edhe pika e/1 dhe kjo thotë që 3/5 duhen vetëm për tjetërsimin e pronës. Ndërsa dhënia në përdorim bëhet me 50%+1. Pika që po diskutojmë tani nuk është për tjetërsim sepse ne nuk po ja kalojmë pronësinë asnjë njeriu thjeshtë po i japim të drejtën ministrisë që të vazhdojë procedurën.

Këshilltar I.Bode : Kodi Civil thotë që tjetërsimi jepet pra kur ti ja kalon pronësinë tjetrit me dhurim me shitje apo me trashëgimi. Në rastin konkret dhënia me qera nuk është tjetërsim, pra ti e ke pronësinë dhe ti ja jep me qera në bazë të një çmimi që ke vendosur . Kurse në lidhje me pëlqimin as këtu nuk jemi në kuadrin e tjetërsimit, pra pëlqimi nuk është tjetërsim, tjetërsimi mund të jetë kompetencë e ministrisë por jo e këshillit bashkiak.

Këshilltar E.Bregu: Në materialin që na ka ardhur thuhet që bashkangjitet skica , por unë nuk e kam parë asgjëkundi këto dokumenta. Cudi si e ka kaluar komisioni. Kemi patur raste të ngjashme të privatizimit të tilla, dmth dhënie pëlqimi për privatizim dhe ajo që dua të di unë është ka ndonjë plan zhvillimi në atë zonë ngjitur me këtë pronë apo jo?

Kryetari i bashkisë S.Filo: Plan zhvillimi nga ana e bashkisë?

Këshilltar E.Bregu: Nga ana e bashkisë ka ndonjë projekt ndonjë gjë?

Kryetari i bashkisë S.Filo: Jo deri tani të paktën, mund të ketë më vonë, por kush është qëllimi?

Këshilltar E.Bregu: Nëse unë kam një pronë timen dhe bëj kërkesën, normalisht kjo është procedurë normale dhe bashkia jep pëlqimin.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Varet nga lloji i pronës nga projektet që ka bashkia në atë zonë, në rast se është një pronë e cila përdoret në mënyrë aktive nga bashkia apo kemi në plan në të ardhme që ta përdorim për një qëllim tonë nuk e japim pëlqimin, pra kemi pasur raste edhe të njëjës arsyetim dhënie përgjigje edhe të tjetrës. Në këtë rast nuk është se kemi ndonjë projekt në atë zonë. Nuk e kemi përdorur ndonjëherë atë pronë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët e tjerë?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 5

### **Pika 15 e rendit të ditës.**

**PËR FILLIM E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA TË OBJEKTIT ME SIPËRFAQE TOTALE PREJ 390 M2, PJESË E PASURISË ME NR.4/167 VOL.42 FAQE 57 ZK 8564, NË ISH UMB KORÇË, SIPAS GENPLANIT BASHKËLIDHUR.**

Këshilltar : Edhe për këtë pikë komisioni ka vendosur që t'ja kalojë këshillit për miratim

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët e tjerë?

Këshilltar E.Bregu: Sa është vlera e qirasë.

Ekzekutivi A.Dishnica: Vlera e qirasë është 200 mijë lekë për metër katror.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 16 e rendit të ditës.**

(SIPAS KËRKESËS TË QËNDRA SPORTIVE KORÇË SH.A ) PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

a - Miratimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2022 të Qendra Sportive Korçë sh.a

Këshilltar P.Tollkuci: Në emër të komisionit ne kemi dëgjuar fjalën e administratorit dhe të ekonomistes, kemi parë edhe raportin e auditimit të ekspertëve kontabël në lidhje me këtë pjesë, është një procedurë rutinë që ndodh në lidhje me këtë pikë. Në këtë komision kemi diskutuar madje të 3 këshilltarët pasi edhe nuk kemi pasur ndonjë eksperiencë të tillë më përpara, jemi sqaruar nga pjesa e administratorit dhe ekonomistes dhe kemi vendosur për kalimin dhe miratimin në këshill të këtij materiali.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje?

Këshilltare I.Seidolli: Unë kisha 3 pyetje , tek pasqyra e të ardhurave, të ardhurat për qendrën sportive korçë rezulton që të jenë për vitin 2022 5,349,017, unë do të doja të dija çfarë është planifikimi për këto të ardhura, sa ka qënë planifikimi për të ardhurat e vitit 2022 sepse më intereson të di me sa % është realizuar ky plan.

Përfaqësues i Qendrës Sportive: Për vitin 2022 parashikimi që kemi bërë ne ka qënë 3,500,000 dhe shpezimi është 5,349,017 lekë.

Këshilltare I.Seidolli: Jo po them të ardhurat që ka grumbulluar qendra sportive kanë qënë rreth 5,000,000 lekë. Kanë qënë të planifikuara për vitin 2022 më shumë apo më pak të ardhura?

Përfaqësues i Qendrës Sportive: Më pak.

Këshilltare I.Seidolli: Kam një pyetje tjetër tek bilanci , tek TVSH-ja e cila rezulton të jetë 2,862,820. Si është menduar arkëtimi i kësaj shume? Pra keni ndonjë marrëveshje me tatimet që kjo shumë të afrohet ndoshta si diferencë apo ndoshta do të kthehet në formë definitive, apo a do kthehet?

Përfaqësues i Qendrës Sportive: Ajo bëhet me sistemim nga tatimet.

Këshilltare I.Seidolli: Ka ndonjë procesverbal që është rënë dakord apo jo?

Përfaqësues i Qendrës Sportive: Jo

Këshilltare I.Seidolli: Pyetja e 3 tek aktivet monetare Qendra Sportive Korçë ka gjëndje bileta me vlerën 13,072,300, pra ju keni bllokuar 130 milion lekë të vjetra për bileta. Këto bileta blihen me plan paraprakisht apo jo ?

Përfaqësues i Qendrës Sportive: Me sistemin e vjetër ekzistonte akoma shitja e biletave në ambientet e jashtme fushat sportive që kemi funksiononim me bileta të cilat cdo vit i parashikonim dhe i shisnim, me ndryshimin e sistemit dhe të mënyrës së organizimit një pjesë e biletave i kemi akoma në funksion.

Këshilltare I.Seidolli: Sepse nuk më bën sens fakti që ju keni planifikuar të blini në një shumë kaq shumë të madhe bileta dhe të ardhurat rezultojnë të kenë kaluar pritshmëritë tuaja. Paraprakisht bëhet një planifikim në lidhje me numrin e biletave që duhet të shisni rakorduar kjo dhe me të ardhurat që do të fitoni? Nuk me rakordon shuma e planifikimit të biletave me numrin e të ardhurave.

Përfaqësues i Qendrës Sportive: Të ardhurat që gjeneron Qendra Sportive Korçë , biletat janë vetëm një pjesë të cilat përdoren shumë pak në momentin që flasim, pjesa tjetër e të ardhurave përdoret me kasat e sistemit të fiskalizimit të cilat fëmijët vijnë marrin shërbime dhe i presin të gjitha tek kasa fiskale , biletat përdoren në raste kur nuk del e aksesueshme recepsioni dhe dikush që ndodhet shumë larg roja apo personeli shkon dhe pret një biletë.

Këshilltare I.Seidolli: Pra në mënyrë të pa eficientë ju keni bllokuar 130 milion lekë të cilat nuk futen sepse ju përdorni këtë sistemin e fiskalizimit në vijim.

Përfaqësues i Qendrës Sportive: Nuk ka shpjegim kjo që sapo thatë.

Këshilltare I.Seidolli: E kuptoj shumë mirë atë që thoni ju por ajo që dua të them unë për ju dhe për këshillin është që 130 milion lekë në mënyrë abuzive janë bllokuar dhe nuk mund të përdoren për diçka tjetër.

Përfaqësues i Qendrës Sportive: Janë specialistë të cilët kanë bërë raportin, nuk jam i gatshëm që të kthej përgjigjen e kësaj por kam përshtypjen që duhet të ketë një keqkuptim. Sasia e biletave që ne kemi blerë është e zakonshme, nuk janë shpenzuar 130 milion lekë, llogaritë që bëhen me biletat që thoni ju 130 milion do të thotë që nqs unë kam marrë 100 bileta dhe vlera e biletës atje është 3000 lekë për të lëshuar pallatin e sportit, ky 3000 lekëshi shumëzohet me 100 bileta dhe të del ajo vlera që unë kam shpenzuar 10,000,000 lekë.

Këshilltare I.Seidolli: Po themi dy gjëra komplet të ndryshme

Përfaqësues i Qendrës Sportive: Kur unë kam pasur nevojë për të blerë biletat për të bërë një parashikim në fillimet e SH.A sesa bileta mund të duheshin dhe unë kam shpenzuar 1,000,000 lekë për të blerë një sasi biletash , tani llogaria që bëhet që del bilanci është që nëse unë do i shes të gjitha këto bileta mund të shkojmë tek vlera 130,000,000 lekë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem këshilltarëve se ka një rregullore , se po e bëjmë si në pazar. Nëse në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës ju për këtë shoqëri jeni apo s'jeni dakord merrni përgjigjen që jep drejtori i qendrës. Ne nuk jemi këtu po kjo po kjo. Keni pyetje tjetër?

Këshilltare I.Seidolli: Unë kam nevojë të dal në konkluzionin e vijueshmërisë të bisedës tonë dhe konkluzioni është ky që ndoshta në vijim është më mirë që ky plan të rishikohet dhe në planin e ri

ekonomik këto 130,000,000 që janë bllokuar me bileta të blera mund të ishin shpenzuar diku tjetër. Të shikohet se si mundet të vihen në punë dhe këto 130,000,000 lekë mos ngelen si mall stok.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Unë kam një vërejtje për pjesën e qendrës duhet të vini të përgatitur kur prezantoni material dhe përvec jush duhet të jenë dhe ekspertët që kanë miratuar bilancin, mos hajdeni me duar në xhep dhe nuk dini të jepni përgjigje të pyetjes. Tani ajo që po kuptoj unë është që vlera 13,000,000 lekë nuk është vlera e harxhuar për të blerë biletat por është vlera e biletës sikur të shiteshe, por kjo është një çështje financiare. Ajo që po them është që ju duhet të vini më të përgatitur, sepse është hera e disatë që vini dhe nuk përgjigjeni, nga ana tjetër në vijim të asaj që tha kryetarja e këshillit edhe këshilltarët sepse materialet i keni marrë më përpara dhe mund të ndodhë dhe në vazhdim që jo çdo pyetje që ju mund të bëni mund t'ju kthehet përgjigje në moment. Kryetarja e Këshillit e tha përvec komisioneve secili prej jush e ka në vazhdim dhe do ta ketë mundësinë që të ngrerë pyetje apo të kërkojë informacione shtesë edhe duke qënë vetë pjesë e mbledhjeve të komisioneve edhe duke kontaktuar drejtpërdrejtë drejtorinë apo institucioni nëpërmjet sekretares së këshillit me qëllim që të kemi mundësi që ta përgatitim informacionin e plotë dhe ta bëjmë diskutimin konstruktiv dhe të sqarohemi.

Këshilltar P.Tollkuci: Kryetari ka të drejtë në lidhje me këtë pjesë , e mbështes që pjesa e qendrës duhet të ishte e përgatitur, gjithësesi nisur nga pjesa që ne mbulojmë sigurisht unë mendoj që atje është pasqyruar jo vlera e blerjes së biletave është si puna e emetimit të një buonoje që vlera e prodhimit të asaj buonoje është 5 lekë por vlera e saj ndryshon dhe realisht në bilanc është paraqitur vlera sikur bëjnë më shumë po të shiteshin për shërbime të ndryshme.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po të ishin pyetur më përpara ata të qendrës mund të përgjigjeshin se sa ishte kostoja , blerja e këtyre biletave.

Këshilltar I.Bode : Bëra një lexim disi të ngadalshëm dhe të kujdesshëm , më dolën disa gjëra për të cilat janë shumë të nevojshme që të sqarohen, sepse të paktën nga ajo që unë kuptoj pa sqaruar këto nuk më duket normale që ta kalojmë për miratim këtë pasqyrë financiare. E para është që duhet ditur si funksionon kjo qëndër, pra sa % ka detyrim ligjor bashkia për subvencionim sepse mesa e lexoj ëshë një shifër goxha e madhe 620,000,000 lekë. Tjetra është shikoj shpenzime për paga dhe më duket gjithashtu një shifër e konsiderueshme. Të paktën duhet të na sqarohet ose të na vihej në dispozicion të shikonim numrin e punonjësve, strukturën, a është kjo strukturë dhe ky numër i përshtatshëm për atë aktivitet që kryen kjo qëndër dhe a është i nevojshëm apo jo , të paktën modestisht të gjykojmë mbi pasqyrat financiare duhet të dijmë numrin e punonjësve dhe strukturën. Tjetra e cila më duket e cuditshme dhe mendoj që kërkon vëmendje është shpenzimi për dieta. Ky shpenzim për dieta ka një shifër për mua jashtëzakonisht të madhe në krahasim me buxhetin pra është gati gjysma, është një gjë fare e thatë këtu dieta , është një shpenzim dhe kaq. Nga e gjithë pasqyra dhe nga e gjithë raporti i auditimit nuk kemi asgjë, mendoj që këtu ka nevojë për transparencë për gjithcka. Mendoj që duhet patjetër një sqarim analitik të paktën për mendimin tim dhe tjetra më duket një shumë e madhe që shpenzime vetëm për ujë dhe energji elektrike janë rreth 80,000,000 lekë në vit apo dhe gazi për ngrohjen. Për mua janë shifra të mëdhaja për një qëndër të tillë dhe në fund fare kemi një fitim që është i vogël, ky fitimi në fakt më duket si marifet kontabilist që të mos dalë me humbje dhe mos dalë fare fare barazim por të ketë dicka . Të paguash gjithë këto shpenzime dhe në fund kjo qëndra të dalë kështu.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Unë do të flas disa gjëra për kuadrin e përgjithshëm të funksionimit të qendrës edhe për misionin dhe qëllimin që ka dhe pastaj Anxhela të thotë dicka për anën juridike për pjesën e punonjësve kush është kompetencë e këshillit dhe juve të jepni informacion për pjesën

e dietave. Qendra e fëmijëve është një nga projektet më të rëndësishme të bashkisë , dhe jam shumë i kënaqur që kemi mundur të realizojmë një investim të tillë në qytetin e Korçës që është në funksion të atyre që janë e ardhmja e qytetit Fëmijët. Është një projekt që besoj se e ka arritur qëllimin deri më sot dhe ka një frekuentim shumë të madh nga fëmijët që ndjekin kurset dhe programet dhe trajnimet që ne ofrojmë në këtë qendër sipas prirjeve dhe dëshirave të fëmijëve. Unë di që numri i fëmijëve që rregjistrohen është përtej kapaciteteve dhe mundësive që ka qendra dhe ne vazhdimisht kemi një listë të madhe të fëmijëve që duan të ndjekin këto kurse por nuk kanë mundësi për shkak të kapacitetit. Kjo është për misionin, tani funksionimi nga ana ekonomike të themi ajo është një shoqëri aksionere e cila menaxhon qytezën e fëmijëve , menaxhon edhe zonën sportive . Pra është në SH.A në pronësi të bashkisë të Korçës, 100% e aksioneve janë të bashkisë , përsa i takon efikasitetit ekonomik, ne nuk kemi institucion që funksionon mbi bazë të fitimit , domethënë qëllimi ekonomik nga pikëpamja ekonomike i bashkisë nuk është që të dalë me fitim. Është që të ofrojë shërbime me standartin më të mirë të mundshëm. Kuptohet atje ku ka mundësi të gjenerohen të ardhura dhe të ketë fitim që mund të përdoret përsëri për qëllim publik në projekte të tjera , por jo atje ku shpenzimet janë më të larta se të ardhurat që gjeneron ai aktivitet ne e mbështetim me buxhetin e bashkisë, pra nuk është se qëllimi final i kësaj sh.a është të gjenerojë të ardhura dhe analiza ja vlen apo nuk ja vlen që të funksionojë dhe të operojë nuk bëhet mbi sa të ardhura sa fitim gjenerohet. Ne duhet të shohim që a e përmbushim misionin , të shtojmë numrin e kurseve, të shtojmë numrin e fëmijëve që bëhen pjesë e kësaj qendreje. Do të isha shumë i kënaqur sikur t dilte me fitim , prapë jam i kënaqur po që se do dilte 0-0 nga ana ekonomike por dhe po të dalë me humbje patjetër që do ta subvencionojmë. Dhe dicka për pjesën e dietave, dietat nuk janë dieta të stafit të punës, janë dieta të ekipeve sportive, qofshin këto të akademisë të futbollit, të ekipit të parë të futbollit. Përsa i takon kostove të operimit ujë, energji elektrike, gas kuptohet që është një strukturë shumë e madhe dhe ka kosto që të sigurosh ngrohjen ftohjen por thashë është pjesë e kësaj iniciative. Do përipiqemi që të ofrojmë standartet më të mira dhe për punonjësit e qendrës , për fëmijët dhe prindërit.

Ekzekutivi A.Dishnica: Atëherë sic e tha dhe kryetari shoqëritë tregëtare funksionojnë në bazë të ligjit për shoqërinë tregëtare dhe kanë organet kryesore që janë asambleja, këshilli mbikqyrës dhe administratorët . Asambleja merr vendime që kanë lidhje me buxhetin raportet financiare,bashkimin ndarrjen shkrirjen e shoqërisë pra merr vendimet madhore të shoqërisë që kanë lidhje dhe me jetëgjatësinë e saj , ndërkohë që për vendime të tjera të një rëndësie me pak të vogël është këshilli mbikqyrës dhe një nga vendimet e këshillit mbikqyrës është dhe miratimi i strukturës të administratës të shoqërisë, pra strukturës se si për të realizuar funksionin e saj cfarë lloj punonjësish i nevojiten, cfarë profesionesh e me rradhë, dhe në raste konkret kështu është bërë miratimi i strukturës me vendim të këshillit mbikqyrës , kjo strukturë pastaj fillon të zbatohet nga administratorët të cilët lidhin kontratat e punës bazuar në strukturë e miratuar nga këshilli mbikqyrës.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Më fal edhe diçka , mund të mos jetë kompetencë e asamblesë së aksionerëve për të miratuar strukturën dhe numrin e punonjësve. Kur të na thuash tani këto të dhënat na thuaj dhe sa është numri i punonjësve se nuk është se e kemi sekret.

Këshilltar E.Haxhilleri : Nga ana ekonomike për pjesën e qendrës unë nuk di t'ju flas, por po ju flas një gjë tjetër që kjo është qendra e vetme në shqipëri me këto përmasa , me këtë funksion . Ana ekonomike të jeni të sigurt që ja vlen sepse është qendra e vetme në shqipëri me kushte dhe me këtë lloj përfshirje. Këtu ka kurse që në shqipëri nuk mund të imagjinohen të ekzistojnë. Për mendimin tim kjo është një qendër që i vlen qytetit. Ardhja e gjithë shqipërisë këtu, sepse vijnë që

shikojnë, kështu që misioni i kësaj qëndre këtu është për fëmijët dhe amatorët që shkojnë dhe luajnë dhe të gjithë ne.

Përfaqësues i Qendrës Sportive: Ndoshta jo për të gjitha pyetjet jam në gjendje ti sqaroj me detaje dhe që kryetari i shpjegoi shumë mirë nga sa mund të përgjigjesha unë. Qendra është shumë dimensionale, funksionon dhe ka aktorë të tjerë me të cilët ne bashkëpunojmë brenda qëndrës, grupi që kujdeset për atë qëndër shkon mbi 45 punonjës por qendra sportive Korçë si sh.a ka në organikën e saj 23 punonjës. Një sqarim të vogël përta i përket kostos nëse mund ta them këtu, mbulon një hapësirë prej 100,000 m<sup>2</sup> ku përfshihen të gjitha fushat, dhomat e zhveshjeve, përfshin dhe pagesat e energjisë elektrike të fushave të qytezës së fëmijëve dhe të stadiumit. Përta i përket dietave këshilli bashkiak ka miratuar që t;ju jepet trajtim ushqimor për ekipin e parë të skënderbeut me vlerën 15,000 lekë në muaj dhe dietat që janë udhëtimet që bëjnë dhe 5 ekipet zyrtare që ka akademia e futbollit të Skënderbeut që janë të moshave të ndryshme. Secilit fëmijë i kalojnë dietat në llogari bankare. Përta i përket numrit qyteza e fëmijëve ka fëmijë unik, janë 606 fëmijë unikë, ndërsa frekuentimi shkon mbi 1500 fëmijë në muaj. Gjithë pjesa tjetër e fushave të gjitha ekipet private që ka qyteti, kemi një marrëdhënie që ata vijnë dhe shfrytëzojnë të gjitha ambientet tona kundrejt kontratave me qira të vogla, të gjitha tarifrat që na i arkëtojnë neve ja u miratojmë në këshillin bashkiak që në fillim të procedurave të qëndrës. Nëse kërkoni informacion tjetër jam i gatshëm në çdo kohë mund të vini dhe në qëndër për ta parë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Luis, jam dakord me atë që tha kryetari që herë të tjera në vazhdim sepse ky është një material i cili është futur me vonesë sepse duhet të kishte kaluar që në mbledhjen e kaluar , jemi vonuar. Ne jemi këshill i ri për të cilët këshilltarët do të kërkojnë informacion të vazhdueshëm dhe ju duhet të jeni të përgatitur për çdo informacion. Unë mendoj ta ndajmë këtu pjesën e diskutimit sepse nëse do të vazhdojmë të ndahemi në detaje do të zgjatemi shumë herë më shumë. Mendoj që të kalojmë në votim, nëse dikujt i ka mbetur ndonjë merak ta shprehë atë merak edhe me votën e tij.

Këshilltar E.Bregu: Së pari e vlerësoj shumë faktin e ekzistencës së qëndrës sportive dhe natyrisht jam dakord me logjikën që ky nuk është një aktivitet biznesi dhe një aktivitet i orientuar nga fitimi, por shikoj që keni një raport të ekspertit kontabël me 3 faqe nuk ka asnjë informacion asnjë lloj analize. Disa shpjegime që morrëm këtu dhe nga administratori që ishte i pa informuar , më shumë u informua këtu sesa dinte para se të vinte në mbledhje . Janë të pamjaftueshme, ndaj mendoj që ky raport i ekspertit kontabël nuk është i vlefshëm. Duhet një raport i detajuar për këtë arsye propozoj që të kthehet dhe mos miratohet , kjo çështje të shtyhet për një ditë tjetër.

Këshilltar P.Tollkuçi: Për procedurë unë e thashë këtë pjesë, tani ne nuk kemi ardhur këtu të diskutojmë apo të flasim për atë që nuk kemi informacion. Për atë që nuk kemi informacion dakord në rregull të kërkojmë informacion. Ne nuk mund të gjykojmë njerëz të cilët janë profesionistë dhe mbajnë përgjegjësi personale. Ne kemi përpara një material i cili është firmosur nga specialistë të fushës.

Këshilltar E.Bregu: Nëse do ta bëjmë diskutimin në debat të tillë vazhdo përgjigju ti, nuk është detyra tënde të përgjigjes për këtë.

Këshilltar P.Tollkuçi: Ti nuk mund të më imponohesh mua për këtë punë. Propozoj ta kalojmë në votim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 2

Këshilltar L.Petri: Të bëj një propozim edhe pse u bë votimi e ngrita dorën pak më përpara. Është thjesht për parim. Kisha thjesht një propozim sepse kam patur rastin të jem me 4 deputetë dhe ju bëj me dije që Gjermania , dmth janë disa shtete që po i mëshojnë shumë energjisë së rinovueshme. Ne e dimë që klima ka arritur këtu ku ka arritur dhe mendoj që sidomos institucionet publike të këtij karakteri me këtë kapacitet, me këtë kërkesë për energji duhet të mendojmë që për planifikim të buxhetit të parashikohen vendosje panelesh, nuk e di janë ekspertë që e dinë atë gjë, por duke qënë se zëri i energjisë është i konsiderueshëm dhe fjala e vetë kryetarit të bashkisë ishte e tillë që synimi nuk është parësor i gjenerimit të të ardhurave, sigurisht ne të gjithë jemi aksionerë dhe do të duam që të jëtë sa më rentabël si institucion. Propozimi im është që ne si këshill të bëjmë cmos që institucione si ky të planifikojnë paraprakisht instalime të energjisë të rinovueshme të cilat është një rikthim në investim shumë i shpejtë.

Këshilltar P.Tollkuci: Kryetare të lutem për procedurë ne si komision për hir të së vërtetës e kemi diskutuar këtë pjesë dhe madje ka qënë Alketa që e ka propozuar këtë pjesë. Jam dakord me parafolsin që të shihet mundësia e ndërtimit të një impianti të tillë nëse do jetë e mundur. Jemi në mbështetje të kësaj.

### **Pika 17 e rendit të ditës.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka të bëjë më përcaktimin e numrit të anëtarëve të kryesisë së fshatit, mënyrës dhe rregullave të votimit. Për dijëni të këshilltarëve ju kërkohet që të dakordësoheni për numrin e anëtarëve të kryesisë së fshatit, ndihmuar nga ekzekutivi bazuar në numrin e popullsisë të cdo fshati një regjistër i tillë është nxjerrë nga zyrat e gjëndjes civile. Numri i anëtarëve të kryesisë për banorë mbi 300 banorë, pra 300-750 banorë të jetë me 5, deri në 300 të jetë me 3, 750- 1250 të jetë 7, 1251-1750 të jetë 9 dhe mbi 1750 deri në 11 anëtarë të kryesisë. Jeni dakord për këtë mënyrë të përcaktimit të numrave të kryesisë bazuar në numrin e popullsisë të cdo fshati? Pra ky është një lloj diskutimi që është bërë me ekzekutivin edhe mbi bazën e popullsisë të fshatrave . Natyrisht që ky proces do të ndiqet nga këshilltarët dhe të gjithë këshilltarët do të jenë pjesë e komisioneve sipas 7 njësive administrative që ne kemi por mendimi im është që për njësitë administrative lekas dhe voskopoje duke qënë se kanë fshatra me një numër shumë të vogël banorësh dhe që janë afër në kufi të njëra tjetrës të kenë një komision të përbashkët. Dakordësohemi që të kemi gjithësej 6 komisione. Jemi dakord të gjithë. Meqënëse u dakordësuam që të kemi 6 komisione, në këto komisione do të përfshihen të gjithë këshilltarët e KB me përjashtim të kryetarit që monitoron të gjithë procesin, përjashtojmë dhe prof Pandin që të lehtësohet nga kjo pjesë e angazhimit. Për njësitë administrative Vithkuq do të ketë 5 këshilltarë, për Voskopoje-Lekas 7 këshilltarë , për njësinë Bulgarec do të ketë 7 anëtarë, njësia Mollaj 7 anëtarë, njësia Voskop 7 anëtarë nga këshilli. Jemi dakord edhe për këtë , dhe Drenova 5. Unë kam përgatitur një listë me emra për secilin nga këto komisione për këto njësi administrative. Po ta linim të lirë asnjëherë nuk do të dakordësoheshim me njëri-tjetrin. Për njësinë Vithkuq do të jenë: Erjon Kurti, Lambert Malavecì, Majlinda Duni, Jorida Romacka, Klajdi Pllaha. Për njësinë

Voskopojë-Lekas: Kostika Zguri, Lorenc Nako, Ornela Alidinaj, Anxhela Taho, Suela Dinellari, Irvin Bode, Lazjon Petri. Njësia Bulgarec : Alma Burda, Gurije Dedelli, Johan Deli, Alketa Zheku, Thoma Marku, Skënder Dinellari. Njësia Mollaj : Ada Përmeti, Majlinda Like, Emiljano Muharrem, Devis Osman, Erald Fejzulla, Altin Habip, Dorina Qyteza. Njësia Drenovë: Valmira Nano, Julian Mema, Elvin Bregu, Julian Kodra, Elvira Muharrem. Njësia Voskop: Erjon Nexhip, Erjols Haxhillari, Marsela Ciromarin, Ismeralda Seidolli, Fidel Kreka, Laurela Alidinaj, Kristiano Kocibelli. Në parim jeni dakord për këtë? Ta kalojmë si pikë të rendit të ditës pastaj për këto ndryshime të vogla flasim me njëri-tjetri. Ky proces duhet të mbyllet brenda datës 14 gusht, kështu që secili prej komisioneve duhet të mblidhet të njihet me procedurën të ndahen detyrat mes veti dhe të kordinojnë më njësitë administrative duke filluar që nga administratori dhe të gjithë strukturat që do merren me këtë proces zgjedhor duke caktuar edhe datat , duke u kujdesur për secilin fshat për banorët që do të votojnë sepse kujdeset administrata e njesisë për tu marrë me këtë proces dhe nëse keni diçka tjetër do të asistoheni nga ana ligjore edhe nga ekzekutivi por edhe nga sekretaria e këshillit. Nëse ka diçka tjetër nga ana juaj?

Këshilltare A.Përmeti: Duke qënë se ne jemi këshilltarë të rinj do ta vlerësoja që ne para se të angazhohemi me diçka dhe të lexojmë secili më vete të mblidheshim dhe të bëjmë një sesion informues ose një trajnim për ne që të na mësojnë se si do funksionojë që dhe ne mos bëjmë gabime.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Unë jam kujdesur që në secilën nga këto grupime të ketë dhe këshilltarë të vjetër të cilët e njohin procesin, janë marrë me këtë proces dhe t'ju asistojnë ju. Nëse do të keni nevojë për një asistim më të specializuar nuk besoj se do të arrijmë dot në kohë sepse është një periudhë pushimesh . Nëse keni nevojë për asistencë ligjore ne kemi juristë , administrata e bashkisë nga ana juridikë do t'ju ndihmojë.

Sekretare E.Naçi: Kam folur edhe me Kristin që është edhe kryetar i komisionit të rregullores dhe do të hartojmë ditën e hënë këto dokumenta standart për çdo fshat që duhet për procesin e zgjedhjeve dhe do i bëjmë gati dhe do ja u japim në dosje këshilltarëve, që ta kenë më të lehtë dhe të jenë të standartizuara për çdo njësi në çdo fshat.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nga eksperiencia ime, jo më kot angazhova të gjithë grupin e këshilltarëve por mes jush do të organizoheni me njëri-tjetrin sepse ju do të jeni mbikqyrës të këtij procesi dhe është mirë që mund të ndani detyra me njëri-tjetrin që dy veta do të ndjekin x fshat dhe 2 veta do të ndjekin x fshat të njësive administrative , nuk është e thënë që të 7 do të jenë në të njëjtin fshat.

Këshilltar K.Koçibelli: Edhe për informacion në ligjin e Vetëqeverisjes Vendore është parashikuar në nenin 70 dhe 71 cilat janë funksionet dhe detyrat që do të ketë këshilli mbi mënyrën se si do ta organizojë, ndërsa përsa i përket rregullores është parashikuar në nenin 173, pra fillimisht kompetencat e komisionit janë që duhet të ketë një diskutim me administratorin e njësive administrative i cili ka dhe një detyrë që duhet të bëjë njoftimin e të gjithë fshatit dhe në votimi që do të bëhet për kryesinë do nxjerrin listat e votimit, ligji e parashikon 10 ditë para, dhe e rëndësishme është që duhet të votojë më shumë se gjysma e fshatit , kjo është një pjesë shumë e rëndësishme për shkak se në rast se voton më pak se gjysma kam idenë që zgjedhjet i bie të jenë të pavlefshme. Më shumë se gjysma e listës së fshatit.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po që se flasim gjysma në raport me listën e fshatit është e pamundur.



Këshilltar K.Koçibelli: Ligji thotë jo më pak se gjysma e banorëve, por pavarësisht kësaj komisionet janë ato që firmosin procesverbalet në fund . Zgjedhjet bëhen fillimisht për kryesinë , kryesia zgjedh kryetarin. Gjithashtu duhet të kemi kujdes sepse duhet të jenë 2 lista, një për meshkujt dhe një për femrat, dhe duhet respektuar gjinia.

Këshilltar K.Pllaha: Si kryetar i komisionit të Etikës dhe Konfliktit të Interesit do të sugjeroja që këshilltarët që kanë dalë nga njësitë administrative të mos jenë pjesë e komisioneve të po të njëjtës njësi administrative, për të evituar konfliktet e interesit.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Këshilltarët që janë me banim.

Këshilltar K.Pllaha: Në listën që kemi ne e kemi të përcaktuar se kë njësi përfaqësojnë. Psh ne kemi anëtarë të këshillit dikë që ka qënë administrator i një njësi administrative, nuk është më por besoj se ka një konflikt interesi po të jetë në komisionin e po të njëjtës njësi administrative.

Këshilltare A.Taho: Unë mendoj që anëtarët e këshillit që janë nga zona duhet të jenë në zonë sepse na ndihmoni ne që nuk jemi nga zona edhe për njohjet brenda fshatit por edhe për lehtësi të tjera. Askush nuk do të ndikojë në këtë proces. Besoj se e kishe fjalën për Kostikën në Voskopoje , e njeh më mirë se kushdo nga ne. Në atë zonë do të na ndihmonte shumë për të gjithë procesin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ta kalojmë në parim këtë gjë meqënëse u vendos si pikë e rendit të ditës dhe më pas do të flasim sërish.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 18 e rendit të ditës.**

#### **INFORMACION PËR UNIVERSITETIN (PROJEKTET, BASHKËPUNIMET ETJ)**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në fakt ne nuk jemi institucioni që duhet të japë informacion për universitetin por do të thoja që bashkia Korçë është një nga bashkitë që është kujdesur më shumë sesa cdo bashki tjetër nëse do ta kishte një universitet. Universiteti i Korçës ka edukuar mijëra studentë të cilët sot ushtrojnë aktivitetin në institucione të ndryshme të bashkive të qarkut të Korçës dhe këtu në KB ka mjaft të tillë të cilët kanë dalë nga ky universitet. Bashkia është kujdesur jashtëzakonisht për të lehtësuar marrëdhënien me universitetin dhe studentët nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, lehtësirat që ka aplikuar me intershipet, kujdesit të studentëve për të përfituar nga tarifat e biletave të aktiviteteve kulturore-sportive të bashkisë, kështu që ne nuk mundet të jemi pjesë e mënyrës se si funksionon ai si institucion , por me ndjeshmërinë për të qënë bashkëpunues.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Unë nuk kam qënë në mbledhjen e fundit por më është kërkuar për të dhënë një informacion nga ana e këshillit në lidhje me bashkëpunimit të deritanishëm me bashkisë Korçë dhe universitetit të Korçës. Në parim njëherë e kam thënë dhe e them vazhdimisht që universiteti është shumë i rëndësishëm për cdo qytet , aq më tepër për një qytet si Korça që ka një lidhje të hershme me arsimin dhe me kulturën, dhe patjetër që interesi i bashkisë është që ne të vazhdojmë të kemi një universitet i cili ti përballojë me sukses sfidat e kohës të cilat nuk janë të

vogla për hir të së vërtetës dhe të jetë një prej gjeneratorëve të zhvillimit ekonomik dhe të furnizimit të qytetit , të bashkisë dhe të rajonit me të rinj dhe të reja dhe të studiuar dhe të trajnuar dhe të cilët pastaj të japin kontributin për zhvillimin ekonomik dhe social të qytetit. Kështu e shoh unë si kryetar bashkie. Në këtë këndvështrim ne kemi qënë të hapur vazhdimisht që të akomodojmë të gjitha kërkesat që kemi marrë nga univeristet duke filluar nga kërkesat për të vënë në dispozicion infratrakturën publike të bashkisë dhe këtu do të listoj vënien në dispozicion të zonës sportive me një marrëveshje që kemi bërë me universitetin për të zhvilluar atje pjesën mësimore dhe të praktikës do ta quaja , degët e sportit në universitetit. Gjithashtu kemi vënë në dispozicion nëpërmjet një kontrate të huapërdorjes objektin e ish konviktit të shkollës mekanike ku është investuar pastaj nga ana e universitetit për të ndërtuar godinën e rektoratit. Ai objekt është një objekt në pronësi të bashkisë që ja kemi vënë në dispozicion universitetit , i kemi vënë gjithashtu në dispozicion edhe godinën e shkollës së mesme Demir Progëri në periudhën kur kishte nevojë për të kryer një rikostruksion të ambienteve të tij që të mos ndërpritej procesi mësimor. Kemi qënë gjithashtu bashkëpunues edhe për të pritur në bashkinë e Korçës dhe në institucionet e varësisë edhe studentë për të kryer praktikat mësimore në zbatim edhe të marrëveshjeve që kemi bërë me fakultetet të ndryshme të këtij universitetit. Kemi hartuar dhe jemi në proces tani për ta plotësuar një listë të shërbimeve të incentivuara që ofron bashkia për studentët e këtij universiteti dhe që do të jenë pjesë e kartës së studentit. Karta e studentit është një procesi i cili kërkon patjetër përfshirjen e universitetit , të këshillit studentor edhe të bashkisë të Korçës dhe përse na takon ne , ne jemi shumë të gatshëm që të ofrojmë kontributin maksimal që kjo kartë të finalizohet dhe t'ju shërbejë studentëve. Jemi përpjekur ta përfshijmë universitetin edhe në programin tonë të madh që do ta shndërojë Korçën në një qëndër të teknologjisë të informacionit dhe komunikimit duke i përfshirë studentët në trajnime të ndryshme që ne kemi ofruar në kuadrin e këtij programi, duke i vënë në dispozicion hapësirat e bashkisë por nga ana tjetër kemi përfituar edhe nga dashamirësia e universitetit dhe rektoratit për të na vënë edhe neve në dispozicion ambiente të universitetit për të organizuar atje një pjesë të kurseve të trajnimit që ne na është dashur të organizojmë gjatë kësaj kohe, pra nuk është se ka qënë marrëdhënie e njëanshme. Kemi pasur gjithashtu pjesë të komunitetit të turizmit edhe petagogë nga ana e universitetit , mbase jo në trajtë të zyrtarizuar në kuptimin e një përfaqësimi të autorizuar nga ana e petagogëve për të qënë pjesë e këtij komuniteti turizmi por kemi pasur petagogë që kanë dhënë kontribut dhe jemi të hapur që këtë bashkëpunim ta kemi edhe në të ardhmen dhe ta thellojmë edhe më tepër. Ne si bashki e respektojmë autonominë e universitetit edhe të gjitha ato të drejta ligjore që lindin nga kjo autonome dhe jemi të gatshëm që të bashkëpunojmë me të gjitha autoritetet e universitetit që duke respektuar autonominë të bëjmë të gjithë një përpjekje madhore që universiteti jo vetëm të ekzistojë për të japë maksimumin e tij për komunitetin e Korçës.

Këshilltari I.Seidolli: Kam një pyetje të shkurtër. Kryetar ju folët tashmë dhe duket si lancim sepse kështu mu pa mua të paktën karta e studentit. Kur mendoni të finalizohet struktura dhe përmbajtja e saj dhe në parim çfarë shërbimesh do të ofrohen për studentët sepe është një çështje që ka qënë në 2018 e cila ka ngelur në tentativë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Duhet ta kuptojmë që në fillim që nuk është detyrim ligjor i bashkisë që të prodhojë dhe të shpërndajë kartën e studentit, pra nuk është detyrim ynë ligjor dhe ne nuk e kemi përmbushur. Ne kemi qënë të gatshëm dhe jemi të gatshëm në vazhdim që fillimisht të hartojmë një listë të shërbimeve që bashkia ka së bashku me inaktivën përkatëse për studentët , jemi gjithashtu të gatshëm që krahas atyre shërbimeve që janë tonat siç mund të jetë transporti publik, sic mund të jetë frekuentimi i teatrove apo i pallatit të sportit, pra përveç shërbimeve që ka

bashkia të sajat jemi duke menduar edhe mbase një lloj ndërmjetësi apo negociate nga ana e bashkisë edhe me biznese private që ofrojnë shërbime ose që shesin produkte që kanë interes studentët, që kuptohet pa u detyruar por në rast se do të kenë gadishmërinë të ofrojnë edhe ata një lloj incentive për studentët e F.Nolit. Ne kemi patur një eksperiencë para disa vitesh me një kartë që e kemi quajtur karta e 16 që synonte të ofronte një listë me shërbime , me përfitues jo studentët por të rinjtë, dhe bazuar mbi ato model po përpiqemi të bëjmë dicka të ngjashme. Detyrimi im është të bëjmë listën e shërbimeve pastaj do të bashkëpunojmë me rektoratin, me Ministrinë e Arsimit për të bërë finalizimin e realizimit të kartës e cila siç thashë nuk është detyrim i bashkisë.

Këshilltare I.Seidolli: Në parim për bizneset të cilat mund të jenë bashkëpunore të këtij projekti mund të kenë lehtësime nga ana e bashkisë .

Kryetari i bashkisë S.Filo: Kjo është pjesë e negociatave që ne do të bëjmë me këto biznese. Për çfarë janë kompetenca jonë patjetër që do ti dëgjojmë, dhe mendoj që karta të jetë interesante duhet të ketë disa shërbime që realisht ju vlejné studentëve dhe që i përdorin më tepër.

Këshilltar L.Petri: Unë mendoj që karta e studentit është vetëm një aspekt, është shumë dytësor për bashkinë. Kuptoj si koncept është në shumë vende perëndimore që atje ka sens sepse atje ka transport publik të mirëfilltë etj, por ju përmendët listën e shërbimeve . Ka bërë bashkia ndonjë listë shërbimesh në të cilat mund të ketë ndonjë interes nga ana e universitetit për të orientuar studentët që të bëjnë diplomat në atë aspekt, dhe ai studim ai kërkim studentor të përkthehet në një vlerë për bashkinë. Unë mund t'ju ilustroj një shembull në lidhje me varrezat. Kam patur rastin që të shoqëroj një zotëri i cili ishte nip i Dhimitër Mborjes patrioti i famshëm, dhe anëtarit të manastirit, dhe ai erdhi i lindur dhe i rritur në Zvicër dhe kërkonte rrënjët , donte të blinte një buqetë me lule tek varrezat. Tani jo domosdoshmërisht rasti është për këtë gjë, varrezat kanë ndryshuar, por sidoqoftë unë u ndodha dëshmitar atje në një procedurë të një ekipi që kishte një qitap si në kohën e vjetër dhe nuk kishte një parcelizim që të thoshte filan familje e ka këtu, ishte një katrahurë e madhe, ku fare mirë sot në epokën dixhitale studentët mund të bëjnë një planifikim të tillë që i vlen dhe bashkisë. Ky është një shembull fare dytësor,por ka shumë shembuj që unë mendoj që duhet të ulet bashkia me universitetin për të gjetur ato pika kontakti ku ka vlerë për të dyja palët.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Patjetër unë do të thoja në vazhdim të kësaj që ne kemi mjaft pedagogë të universitetit kështu që komunikim mes bashkisë dhe universitetit duhet të jetë më i afërt.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Domethënë kjo më tepër ka lidhje me këtë pjesën e praktikave mësimore, do ta fusja në këtë kuadër. Pra nëse e kuptova drejt pyetja është se sa është gadishmëria e bashkisë për të përfshirë studentë të universitetit për të kryer me ose pa pagesë disa procese punë që edhe ne na shërbejnë sepse na duhen por edhe studentëve mund t'ju shërbejnë sepse marrin një lloj eksperience.

Këshilltar L.Petri: Nuk ka lidhje me eksperiencën, është punë më shumë sesa mund të bëhet një tezë masteri fjala bie për një tematikë të caktuar që ka lidhje me shërbimin e bashkisë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Nuk i ka ndaluar njeri, bile jemi shumë të mirëpritur.

Këshilltar L.Petri: Fakti që nuk i keni ndaluar s' do të thotë që i keni stimuluar për këtë gjë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Tani se ka disa gjëra, një nga funksionet e universitetit mendoj unë është kjo që ju sapo thatë, që kërkimi shencor po e filloj që nga tezat e diplomave, tezat e masterit dhe të doktoraturave duhet të jenë të lidhura me realitetin ekonomik ku universiteti po funksionon. Në rastin konkret bashkia e Korçës, qyteti i Korçës dhe kjo është një prej vërejtjeve që unë e kam bërë vazhdimisht në raport me universitetin. Pra orientojeni kërkimin tuaj shkencor drejt gjërave që janë të prekshme dhe të vlefshme për këtë komunitet, sepse edhe ndihmoni komunitetin duke i dhënë një produkt që i vlen por ndihmoni edhe veten tuaj. Jemi shumë të gatshëm dhe të mirëpritur që ta kemi këtë lloj bashkëpunimi. Tani kjo është pula vezën apo veza pulën, në kuptimin që duhet bashkia të japë një listë të problematikave universitetit dhe ata të fillojnë të orientojnë një pjesë të kërkimeve të tyre shkencore për këto gjëra apo duhet universitetit të vijë dhe të thotë çfarë keni ju si problem në fushën e turizmit apo shërbimeve. Është një prej gjërave që universiteti duhet ta bëjë tani, na vlen të dyja palëve. Tjetra që unë e fillova është edhe e praktikave mësimore apo orientimi i studentëve që të bëjnë disa gjëra praktike, dhe ata të mësohen dhe neve të na vlejë për ndonjë gjë. Edhe këtu ka shumë mundësi, dhe mangësi. Ja të marrim rastin e guidave turistike nuk ka njeri, tani çfarë mendojnë studentët dhe pedagogët që një pjesë e tyre të merren dhe të bëjnë këtë pjesën e guidesë duke e parë dhe si një prespektivë për të ardhmen sepse jo të tërë do të punojnë në shtet. Ka shumë kërkesë për guida me çfarë është thënë dhe nuk ka. Pse nuk ka një iniciativë të tillë nga ana e universitetit, dmth duhet të ulemi, ne jemi shumë të gatshëm, sepse kemi nevojë. Kemi projekte të caktuara të cilat kërkojnë staf jo të përhershëm.

Këshilltar L.Petri: Jam shumë dakord, e keni bërë si kërkesë si propozim.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Tani unë e kam orientuar stafin tim që merret me fusha të ndryshme, konkretisht edhe atë të turizmit që shikojeni mundësinë e bashkëpunimit me universitetin. Pra ju kërkoni konkretisht departamenteve atje që të angazhojnë një pjesë të studentëve për këto procese. Tani informacion të detajuar për këtë gjë nuk ta jap dot në këtë moment, por unë e kam pasur gjithmonë këtë gjë sepse të dyja palëve na duhet. Po e mbyllim këtë çfarë ka, dhe si ka funksionuar deri tani, mundësitë për të ardhmen janë të shumta. Për tu kthyer tek ky programi i E-City-së unë e kam me shumë qejf këtë program sepse realisht mendoj që mund të japë një kontribut shumë të madh edhe të drejtpërdrejtë në të ardhmen në një qytet si Korça që ka sfida ka kufizime të caktuara në raport me gjeografinë dhe parametra të tjera. Kam dashur shumë ta përfshij universitetin në këtë program. Kemi ofruar shumë trajnime shumë sesione informuese për të rinjtë të universitetit. Nuk vijmë të rinjtë dhe të rejat që të ndjekin këto trajnime, ku në fakt ajo nuk është që bëhet për mua. Bëhet fjalë për këta të rinj dhe të reja që të kuptojnë se kush janë prespektivat e punësimit në këtë botë që po ndryshon kaq shpejt dhe që teknologjia do të jetë pjesë dominante e të ardhmes. Vuajmë shumë. Thirrje të njëpasnjëshme të pedagogëve, studentëve por nuk vijmë. Këto sesione informimi janë falas.

Këshilltar J.Deli: Për pjesën e kodimit ishte program për financim 100% për ata që ishin të papunë dhe nuk është se kemi pasur ndonjë bum.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Në pjesën e universitetit duhet të ketë një përpjekje më të madhe që edhe të informohen për ato iniciativat dhe prioritetet e bashkisë edhe të përpiqen që ti përcojnë tek pjesa e studentëve dhe të pedagogëve. Ka shumë për të bërë. Ne jemi shumë të gatshëm për të bashkëpunuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është kërkuar dhe një informacion tjetër në lidhje me KLSH-në, është dërguar me email. Ne nuk kemi çfarë të diskutojmë në raport me KLSH-në. Informacione në fakt të kësaj natyre mund ti gjeni lehtësisht edhe vetë në faqen zyrtare.

## **Pika 19 e rendit të ditës.**

### **KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ardhur në kërkesë nga z.Abdulla Meçe nga Voskopi, një banor i këtij fshati i cili kërkon një ndihmë financiare dhe e kërkon të menjëhershme sepse familja e tij përbëhet nga 6 anëtarë me problematika të ndryshme sociale. Kërkesën e tij ja kemi dërguar cështjeve sociale për ta shqyrtuar, kështu që nëse ka diçka ju lutem.

Ekzekutivi A.Vranishti: Lidhur me këtë shqetësim që ka ngritur kjo familje, ai kërkon që ti vemë në dispozicion paketë ushqimore të përmuajshme që bashkia e ka pak të vështirë këtë paketë, ne do i mundësojmë një paketë ushqimore nëpërmjet një shoqate dhe më pas do të shikohet mundësia e bashkisë. Ne do të shkojmë tek kjo familje, është një paketë e mjaftueshme. Është në skemën e kujdesit social kjo familje, kjo është një shtesë, sepse ata janë 6 anëtarë.

Këshilltar E.Fejzulla: Nëse ka ndonjë mundësi tjetër këshilli për të ndihmuar me ndonjë arkëtim fondi ose nuk e di.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E vetmja mundësi është që ne të vemë në dispozicion nga pagesat tona.

Këshilltar E.Fejzulla: Ka mundësi që unë ta bëj nga pagesa ime.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Unë jam njohur me rastin, madje e kam takuar , i kam pritur edhe në zyrë zonjën dhe fëmijët e saj. Tani kjo pjesa e mbështetjes për këto kategoritë në nevojë është e përcaktuar pra ka një kuadër ligjor, është pjesa e ndihmës ekonomike ose e paketës së paaftësisë që ka kriteret e përcaktuara se kush e përfiton edhe masën e përfitimit. Këta kishin edhe problemin e heqjes së një kempit për të cilën ju thashë që të drejtohen tek SHSSH mbase mund të asistohen që tu lehtësohet ky kontakti, sepse kjo pjesa e kempit del përtej kompetencave të bashkisë, nuk e cakton komisioni ynë, e cakton komision mjekësh. Për pjesën e pakove ushqimore ato nuk është se realizohen deri tani të paktën nga ana e bashkisë. Ne kemi bashkëpunim me shoqata të ndryshme ku i orientojmë për pjesën e rasteve që shohim që janë raste ekstreme.

Këshilltar E.Fejzulla: E kuptoj që mundësia është e tillë, është bërë maksimumi por unë me veten time e kisha parashikuar një gjë të tillë që atë pagesë që do merrja do e jepja për bamirësi kështu që meqë është rasti , që është vërtet në nevojë dhe janë të pamundur për të krijuar mundësi të tjera, do të isha përsëri i gatshëm.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do ju lutesha këshilltarëve për të hapur numrat e llogarive bankare , ekzekutivi përsëri do më thotë se ne cilat banka.

Ekzekutivi V.Ziko: Raiffaisen dhe BKT.

Këshilltar J.Kodra : Në mbledhjen e kaluar nuk kam marrë pjesë se ishte vendosja e anëtarëve të komisioneve dhe erdha disa minuta me vonesë dhe pika 3 kishte kaluar, do të doja të dija si operoi sepse është edhe detyrim që ne të përfaqësojmë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ke shumë të drejtë , edhe me kryesinë e kemi diskutuar, ju jeni 2 këshilltarë të cilët nuk i kemi vendosur në asnjë komision për shkak të mungesës kur janë ndarë komisionet. Me qënë se komisionet duhet të jenë me numër tek atëherë i bie që të dy ju sëbashku

të vendoseni në një komision sepse nëse do të ndaheni në komisione të ndryshme do të ndryshonim raportin të numrit tek në komision. Të dy sëbashku do të vendoseni në një komision që është edhe i përshtatshëm për juve.

Këshilltar J.Kodra: Do t'ju jepja një zgjidhje më të thjeshtë duke parë se disa këshilltar janë në 3 komisione mendoj që edhe ne do ti lehtësojmë nëse futemi në një nga këto komisionet, psh Erjon Kurtit e shikoj në 3 komisione dhe me mirëkuptimin e tij do të thoja që dhe nga formimi dhe nga eksperiencia ime në komisionin e Cështjeve Ligjore, Rregullores mund të futem unë, ose Gurija them që ta ndihmoja. Duke qënë se kam dhe 10 vjet që operoj dhe në shërbim pyjor mund të ishte dhe një zgjidhje e mirë që ta lehtësoja Gurijen në këtë pjesë në Komisionin e Bujqësisë dhe të Pyjeve.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Secili ka të drejtë të marrë pjesë.

Këshilltar J.Kodra: Të gjithë kemi të drejtë por ka disa që janë në 3 komisione dhe ne jemi të papërfaqësuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do të përfaqësoheni patjetër.

Këshilltar E.Bregu: Ne rradhën e kaluar ju dërguam një kërkesë që partia demokratike ka bërë për zyrën dhe na thatë që në këtë mbledhje do na kthenit përgjigje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Duke qënë se dhe kryetari i grupit nuk është, për të qënë dhe ai prezent në mbledhje për ta shqyrtuar.

Këshilltar E.Bregu: Ne e ngritëm si çështje këtu që do të trajtohet.

Sekretare E.Nacçi: Ka një përgjigje sepse keni bërë një kërkesë me numër protokollit, është nisur një përgjigje drejt jush dhe është kthyer mbrapsht sepse adresa nuk ishte e saktë.

Ekzekutivi A.Dishnica: Mund të vesh ta marrësh tek protokollit zarfin që është kthyer mbrapsht sepse nuk ishte adresa e saktë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E quaj mbledhjen e mbyllur.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

**KRYETARI**  
**ANA VERUSHI**